Vendim nr. 289, datë 16.09.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Genti Ibrahimi,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 16.09.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 3 (Z) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ZAHO NESTURI,** përfaqësuar nga avokati Admir Thanza me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2026-250, datë 28.01.2026 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 4, 15, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja "f", 132, 134, pika 1, shkronja "i", dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, paragrafi i parë dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj; nenet 21, 27, 71, pika 1, 71/a, 71/b dhe 76 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën dhe dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Zaho Nesturi është në mosmarrëveshje pronësie me të atin, Dh.N., dhe vëllezërit P.N. e G.N. Kërkuesi dhe i ati, si banorë të fshatit Palasë dhe anëtarë të ish-kooperativës bujqësore të këtij fshati, në cilësinë e kryefamiljarëve, kanë përfituar tokë në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën" *(ligji nr. 7501/1991)*, përkatësisht kërkuesi një sipërfaqe prej 3300 m^2 tokë arë dhe ullishte në vendin e quajtur "Bardhi", ndërsa Dh.N., ndër të tjera, një sipërfaqe prej 2400 m^2 tokë arë dhe ullishte në të njëjtin vend.

2. Sipërfaqja e tokës prej 3300 m^2, nga e cila 1000 m^2 tokë arë dhe 2300 m^2 ullishte, fillimisht i është dhënë kërkuesit në përdorim. Sipas aktit të marrjes së tokës në përdorim, ajo identifikohej me numrin kadastral 27/21 dhe kufijtë: Veriu - rrugë; Lindje - Dh.N.; Jugu - rrugë; Perëndimi - rrugë. Më pas, kjo sipërfaqe toke i ka kaluar kërkuesit në pronësi sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi (*AMTP*), me të njëjtët kufij.

3. Edhe Dh.N. ka përfituar në pronësi një sipërfaqe toke prej 2400 m^2, nga e cila 1500 m^2 tokë arë dhe 900 m^2 ullishte. Sipas AMTP-së së tij, kjo pasuri identifikohej me numrin kadastral 27/29 dhe kufijtë: Veriu - L.B. dhe xhade; Lindje - G.N.; Jugu - G.N.; Perëndimi - N.B. Duke kundërshtuar numrin kadastral të pasqyruar në këtë akt, Dh.N. i është drejtuar Komisionit të Tokës pranë Bashkisë së Himarës, i cili, me vendimin e datës 20.02.2004, ka vendosur ndryshimin e këtij numri nga 27/29 në 28/29, duke urdhëruar pasqyrimin e ndryshimit edhe në formularin nr. 6 të administruar nga zyra e kadastrës.

4. Në lidhje me tokën e dhënë atij në pronësi, kërkuesi ka vënë në lëvizje tre procese gjyqësore, fillimisht për korrigjimin e numrit kadastral të parcelës, më pas për njohjen e pronësisë mbi një ndërtesë dhe truallin funksional të saj, ndërsa së fundi për lirimin dhe dorëzimin e sipërfaqes së tokës ullishte dhe kundërshtimin e lejeve të ndërtimit.

Procesi për korrigjimin e numrit kadastral të parcelës

5. Kërkuesi, duke pretenduar se numri kadastral i parcelës nuk përputhej me vendndodhjen e tokës së dhënë fillimisht në përdorim dhe më pas në pronësi, sipas kufijve të përcaktuar në aktet përkatëse dhe vendndodhjes së pronave kufitare, iu është drejtuar organeve administrative dhe më

pas gjykatës me padi, duke kërkuar detyrimin e Komisionit të Tokës pranë Bashkisë së Himarës për ndryshimin e numrit kadastral të parcelës së pasqyruar në AMTP dhe shoqërimin e këtij akti me skicën përkatëse. Në këtë gjykim ka marrë pjesë, si ndërhyrës dytësor, edhe Dh.N.

6. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 698, datë 18.03.2008 (*vendimi nr. 698/2008*), ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke detyruar Komisionin e Tokës pranë Bashkisë së Himarës të disponojë me vendim për ndryshimin e numrit kadastral të parcelës së pasqyruar në AMTP-në e kërkuesit, nga 27/21 në 28/21. Nga ana tjetër, gjykata ka rrëzuar kërkimin tjetër të padisë për shoqërimin e AMTP-së me skicën përkatëse.

7. Për sa i përket korrigjimit të numrit kadastral të parcelës, gjykata, pasi ka administruar si provë edhe një akt ekspertimi topografik, ka arritur në përfundimin se numri kadastral i parcelës së pasqyruar në AMTP-në e kërkuesit, pra 27, ishte i gabuar dhe nuk i përgjigjej vendndodhjes së pronës dhe kufijve të saj, të cilëve u korrespondonte parcela me numrin kadastral 28. Në këtë drejtim, gjykata ka evidentuar se, sipas hartës kadastrale të shkallës 1:5000, parcela me numrin kadastral 27 ndodhej brenda qendrës së banuar të fshatit Palasë dhe i përkiste zërit "pemëtore", ndërkohë që sipërfaqja e tokës së përfituar nga kërkuesi, sipas AMTP-së, ishte "ullishte" dhe vendndodhja dhe kufijtë e saj nuk përputheshin me këtë parcelë. Po kështu, gjykata ka vlerësuar se sipërfaqja e përgjithshme e parcelës nr. 27, prej rreth 4000 deri në 5000 m^2, nuk mund të përfshinte 21 nënndarje, ku vetëm nënndarja 21, që i ishte dhënë në pronësi kërkuesit, të kishte një sipërfaqe prej 2.300 m^2. Gjykata ka marrë parasysh edhe faktin se, me vendimin e datës 20.02.2004, Komisioni i Tokës pranë Bashkisë së Himarës kishte korrigjuar nga 27/29 në 28/29 numrin kadastral të parcelës së Dh.N., i cili, sipas AMTP-së, rezultonte kufitar me kërkuesin.

8. Për sa i përket kërkimit për shoqërimin e AMTP-së me skicën përkatëse, eksperti ka sqaruar se ky akt, sikurse edhe akti i marrjes së tokës në përdorim, nuk shoqërohej me skicë ose hartë që të tregonte vendndodhjen reale të pronës. Sipas tij, fshati Palasë ende nuk ishte përfshirë në sistemin e ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, pra ishte një zonë e pamenaxhuar, dhe nuk ekzistonte një hartë kadastrale ku të ishin pasqyruar nënndarjet e parcelave dhe pasuritë e përfituara sipas ligjit nr. 7501/1991, përfshirë ato të palëve ndërgjyqëse. Në këto kushte, eksperti, duke iu referuar vendndodhjes së treguar nga kërkuesi në terren, ka pasqyruar në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 parcelën/ngastrën që kërkuesi pretendonte se i ishte dhënë në pronësi sipas AMTP-së. Ky pozicionim është kundërshtuar nga ndërhyrësi dytësor Dh.N., i cili ka pretenduar se

e njëjta sipërfaqe toke i ishte dhënë atij në pronësi sipas AMTP-së së tij. Në këtë situatë faktike, gjykata ka rrëzuar kërkimin e padisë për shoqërimin e AMTP-së me skicën përkatëse, duke arsyetuar se mungonte një hartë kadastrale që të pasqyronte nënndarjet e parcelave sipas ligjit nr. 7501/1991. Për të njëjtat arsye ajo nuk ka pranuar as prapësimin e ndërhyrësit dytësor për mbivendosje të pronave. Gjykata ka arsyetuar gjithashtu se kërkuesi nuk kishte kërkuar në rrugë administrative përmbushjen e detyrimit përkatës nga Komisioni i Tokës pranë Bashkisë së Himarës, si organi i ngarkuar nga ligji nr. 7501/1991 dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm kadastral.

9. Vendimi nr. 698/2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 215, datë 03.06.2009. Ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 257, datë 18.03.2011, ka vendosur mospranimin e rekursit të ndërhyrësit dytësor.

Procesi për pronësinë e një ndërtese dhe truallin funksional të saj

10. Kërkuesi, në të njëjtën periudhë, ka paraqitur në gjykatë edhe një padi tjetër, duke kërkuar detyrimin e të padituritit Dh.N. për pushimin e cenimit të pronësisë, lirimin dhe dorëzimin e një banese me sipërfaqe ndërtimi 40 m^2, njohjen e pronësisë mbi këtë banesë dhe truallin funksional prej 300 m^2, si dhe lirimin e dorëzimin e këtij të fundit. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 1986, datë 21.07.2008 (*vendimi nr. 1986/2008*), ka vendosur detyrimin e të padituritit Dh.N. të njohë kërkuesin si pronar të ndërtesës me sipërfaqe ndërtimi 30 m^2 dhe të truallit funksional me sipërfaqe 158 m^2, gjithsej 188 m^2, të ndodhur në vendin e quajtur "Bardhi", në fshatin Palasë, me kufij sipas aktit të ekspertimit, si dhe t'ia lirojë dhe dorëzojë këtë pasuri.

11. Në arsyetimin e saj, gjykata ka pranuar se, me vendimin e datës 25.04.1990 të Këshillit Popullor të fshatit Palasë, kërkuesit i ishte dhënë e drejta për ndërtimin e një shtëpie, në vendin e quajtur "Bardhi", ndërsa me vendimin e datës 26.12.1991 kishte ndryshuar destinacioni i ndërtimit për ushtrimin e aktivitetit privat. Gjykata ka konstatuar se kërkuesi kishte ndërtuar një objekt dykatësh, me njërin kat nëntokë, me sipërfaqe 30 m^2, i cili ishte i papërfunduar. Ndërkohë, ajo ka administruar si provë një akt ekspertimi topografik, sipas të cilit AMTP-të e kërkuesit dhe të Dh.N. nuk shoqëroheshin me skicë ose hartë ku të pasqyroheshin forma, pozicioni dhe përmasat e parcelave/ngastrave përkatëse. Ndonëse në hartën kadastrale të shkallës 1:5000 ishte pasqyruar

parcela me numër kadastral 28, nuk ishin pasqyruar nënndarjet e saj, çka, sipas ekspertimit, tregonte se menaxhimi i kësaj zone nuk ishte bërë. Për rrjedhojë, pavarësisht se pasuritë e palëve identifikoheshin brenda parcelës nr. 28, nga të dhënat e disponueshme nuk mund të përcaktohej nëse ndërtimi i kërkuesit mbivendosej ose jo me pasuritë sipas AMTP-ve përkatëse. Mbi këtë bazë, gjykata ka vlerësuar se nuk mund të përcaktohej nëse ndërtimi i kërkuesit ishte bërë në tokën e dhënë në pronësi të Dh.N. Megjithatë, sipas gjykatës, edhe sikur ndërtesa e kërkuesit me sipërfaqen funksionale (158 m^2) të mbivendosej me pronën e Dh.N., duke iu referuar si këqyrjes në vend, ashtu edhe vendimit të Këshillit Popullor të fshatit Palasë, ndonëse ndërtimi i kërkuesit ndodhej në parcelën nr. 28/29, ai ishte jashtë sipërfaqes së tokës së dhënë në pronësi të Dh.N. Mbi këtë bazë, gjykata ka pranuar pjesërisht padinë e kërkuesit.

12. Vendimi nr. 1986/2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 92, datë 01.02.2011. Ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-1040, datë 09.05.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të të padituri.

Procesi për mbrojtjen e pronësisë mbi tokën ullishte dhe kundërshtimin e lejeve të ndërtimit

13. Këshilli i Rregullimit të Territorit i Bashkisë së Himarës (*KRRT*), me vendimet nr. 24, datë 15.04.2006 dhe nr. 46, datë 25.11.2006, ka miratuar kërkesën e P.N. (vëllai i kërkuesit) për leje sheshi ndërtimi dhe leje ndërtimi të një objekti dykatësh, me sipërfaqe 120 m^2.

14. Në datën 08.03.2010, duke pretenduar se aktet e mësipërme të KRRT-së kishin të bënin me një sipërfaqe toke në pronësinë e tij, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi, me objekt lirimin dhe dorëzimin nga të padituri të një sipërfaqeje toke ullishte dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve të KRRT-së për leje sheshi dhe leje ndërtimi. Ai ka kërkuar edhe marrjen e masës së sigurimit të padisë, pezullimin e çdo ndërtimi mbi sipërfaqen 2300 m^2 dhe ndalimin e regjistrimit të ndërtimeve të kryera nga të padituri mbi këtë tokë në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë *(ZVRPP, Vlorë)*. Më konkretisht, kërkuesi ka kërkuar lirimin dhe dorëzimin nga i padituri P.N. të sipërfaqes prej 2000 m^2 dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të lejeve të dhëna në favor të tij, ndërsa nga të padituri Dh.N. dhe G.N. lirimin dhe dorëzimin e një sipërfaqeje prej 200 m^2 nga secili, të cilat, sipas kërkuesit, ishin në pronësi të tij dhe ndodheshin në vendin e quajtur "Bardhi" në fshatin Palasë.

15. Gjatë gjykimit, të paditurit Dh.N. dhe G.N. kanë paraqitur kundërpadi, duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë absolute të AMTP-së në emër të kërkuesit dhe çregjistrimin e këtij akti nga regjistrat e zyrës së kadastrës të Këshillit të Qarkut Vlorë dhe nga regjistrat e ZVRPP-së, Vlorë. Gjykata e shkallës së parë, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur shqyrtimin në një gjykim të vetëm të padisë dhe kundërpadisë, duke çmuar se kjo e fundit kishte lidhje me objektin e padisë.

16. Gjatë gjykimit, gjykata ka administruar si provë edhe një akt ekspertimi topografik dhe shtesën e tij, si dhe ka dëgjuar shpjegimet e ekspertit në seancë gjyqësore. Në aktin e ekspertimit janë pasqyruar vendndodhjet e pronave të treguara nga palët, sipas pretendimeve të tyre, duke evidentuar se pretendimet përkatëse përfshinin të njëjtën sipërfaqe toke. Sipas këtij akti, Dh.N. ishte trajtuar me tokë në vendin e quajtur "Bardhi" të fshatit Palasë, me sipërfaqe gjithsej 2400 m^2, nga e cila 900 m^2 ullishte, e cila nuk ishte prekur dhe ndodhej në veri-perëndim të ndërtimit të bërë nga P.N. Ky i fundit kishte realizuar një ndërtim me sipërfaqe 150 m^2 dhe oborr të rrethuar, me sipërfaqe të përgjithshme 1250 m^2. Në shtesën e aktit të ekspertimit është krahasuar vendndodhja e pronës së treguar në terren nga kërkuesi me pozicionimin e saj sipas planimetrisë së administruar në gjykimin e përfunduar me vendimin nr. 698/2008. Sipas ekspertimit, ndonëse të dyja pozicionimet i përkisnin së njëjtës zonë kadastrale dhe të njëjtit emër vendi, ndërmjet tyre rezultonin dallime në pozicionim prej 14,6 ml në pjesën jugore dhe 16,5 ml në pjesën veriore, sipas drejtimit perëndim-lindje (skica nr. 5). Sipas planimetrisë së shkallës 1:5000 të vitit 1972, prona e kërkuesit pozicionohej mesatarisht 15.7 ml më në lindje. Nga pasqyrimi sipas hartës së fotografisë ajrore të Institutit Ushtarak të Topografisë, rezultonte një ndryshim në raport me rrugën automobilistike, çka sillte mbivendosje të pjesshme të pronës së kërkuesit me rrugën, banesën e tij, një pjesë të banesës së Dh.N. dhe oborrin e kësaj të fundit, ndërsa banesa e Dh.N. rezultonte të ishte ndërtuar përpara vitit 1990 (skica nr. 6). Në shpjegimet e dhëna gjatë gjykimit, eksperti ka sqaruar se, për shkak të mungesës së menaxhimit të zonës, pasqyrimi dhe përcaktimi i vendndodhjes së pasurive në terren sipas AMTP-ve, të cilat nuk shoqëroheshin me skica/harta, ishte mjaft i komplikuar dhe i paqartë.

17. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. 2835, datë 16.10.2012, ka vendosur rrëzimin e padisë dhe të kundërpadisë si të pabazuara. Në arsyetimin e saj, duke trajtuar autoritetin e gjësë së gjykuar, gjykata ka vlerësuar se vlefshmëria e titullit të pronësisë së kërkuesit ishte konfirmuar nga vendimet gjyqësore të formës së prerë nr. 698/2008

dhe nr. 1986/2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ndaj pretendimet për paligjshmërinë e AMTP-së së kërkuesit nuk merreshin në konsideratë. Duke iu referuar vendimit nr. 698/2008, gjykata ka konsideruar si fakte të provuara se numri kadastral 27/21 i pasqyruar në AMTP-në e kërkuesit ishte i gabuar, pasi nuk përputhej me vendndodhjen dhe kufijtë e pronës së tij, së cilës i korrespondonte numri kadastral 28/21. Po kështu, ajo ka konstatuar se me vendimin e Komisionit të Tokës pranë Bashkisë së Himarës, datë 20.02.2004, ishte ndryshuar numri kadastral i ngastrës së Dh.N. nga 27/29 në 28/29. Në këtë mënyrë, sipas titujve të pronësisë, pasuritë e palëve identifikoheshin me numrat kadastralë 28/21 dhe 28/29, përkatësisht në parcelën/ngastrën 21, në pronësi të kërkuesit, dhe në parcelën/ngastrën 29, në pronësi të Dh.N., brenda parcelës kadastrale nr. 28. Mbi këtë bazë, gjykata ka arritur në përfundimin se objektivisht ndërmjet pronave nuk mund të kishte mbivendosje për shkak të titujve të pronësisë, për sa kohë ato identifikoheshin me nënndarje të ndryshme të së njëjtës parcelë kadastrale. Sipas saj, ky përfundim mbështetej edhe në vendimin nr. 1986/2008 dhe në shtesën e aktit të ekspertimit të administruar në gjykimin aktual, referuar skicës nr. 5.

18. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar, gjithashtu, se kërkuesi ishte konfuz për vendndodhjen e pronës së tij, pasi, ndonëse në procesin gjyqësor të përfunduar me vendimin nr. 698/2008 kishte pranuar pozicionimin e pronës sipas ekspertimit të administruar në atë gjykim, në procesin aktual pretendonte një pozicionim tjetër, që përputhej me sipërfaqen e pretenduar nga Dh.N. Po kështu, gjykata ka evidentuar se, megjithëse leja për shesh ndërtimi dhe leja e ndërtimit në favor të P.N. datonin nga viti 2006, në gjykimin e përfunduar me vendimin nr. 1986/2008 kërkuesi nuk kishte ngritur pretendime për lirimin dhe dorëzimin e sipërfaqes së tokës objekt të procesit aktual, por ishte kufizuar në kërkimet për ndërtesën dhe truallin funksional të saj. Sipas gjykatës, pozicionimi i pronës është një rrethanë faktike që gjykata mund ta konstatojë, por jo të ndryshojë në varësi të pretendimeve të palëve. Nisur nga kjo, ajo ka vlerësuar se, për sa kohë kërkuesi kishte pranuar efektet e vendimit nr. 698/2008, ku sipas skicës së aktit të ekspertimit të administruar në atë gjykim pozicionimi i pronës së tij rezultonte i ndryshëm nga ai i pronës së Dh.N., pretendimi se sipërfaqja e tokës në pronësi të tij ishte ajo e njohur me AMTP në pronësi të Dh.N., nuk provohej në këtë gjykim. Për rrjedhojë, gjykata ka çmuar se kërkimi për lirimin dhe dorëzimin e sendit ishte i pambështetur në ligj dhe në prova.

19. Për sa i përket kërkimit për pavlefshmërinë e lejeve të ndërtimit, gjykata ka çmuar se kërkuesit i mungonte legjitimimi aktiv, pasi, sipas shtesës së aktit të ekspertimit, referuar skicës nr. 6, nuk rezultonte që ndërtimi i P.N. të ndodhej në sipërfaqen e tokës në pronësi të kërkuesit. Po kështu, gjykata ka vlerësuar se edhe të paditurve/kundërpaditës u mungonte legjitimimi aktiv për kundërshtimin e AMTP-së së kërkuesit, duke qenë se, sipas saj, nga akti i ekspertimit dhe vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. 1986/2008 rezultonte se ndërmjet pronave të palëve nuk kishte mbivendosje. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi, ndërsa të padituri kundërpaditës kanë paraqitur apel kundërshtues.

20. Pas shpalljes së moskompetencës lëndore nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 1378, datë 23.09.2014, çështja është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila, me vendimin nr. 2567, datë 14.09.2016, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 2835, datë 16.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, duke u mbështetur në të njëjtat argumente. Kundër këtij vendimi kërkuesi ka paraqitur rekurs, ndërsa pala tjetër kundërrekurs.

21. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2026-250, datë 28.01.2026, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), ekzistenca e të cilave mund ta bënte të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit. Sipas atij kolegji, në rekurs nuk ishte parashtruar asnjë argument i qenësishëm që të lidhej me ndonjërin prej shkaqeve për të cilat mund të ushtrohej e drejta e rekursit, si dhe nuk rezultonte ndonjë çështje ligjore që mund të shqyrtohej kryesisht nga Gjykata e Lartë.

22. Në datën 12.06.2026 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij. Ky ankim, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 19.06.2026. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

23. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

23.1. *E drejta për proces të rregullt* në drejtim të:

23.1.1. *Së drejtës së aksesit substancial në gjykatë,* për shkak se gjykatat nuk i kanë dhënë zgjidhje përfundimtare mosmarrëveshjes për të drejtën e pronësisë, duke mos përcaktuar se cilës palë i përkiste sipërfaqja e tokës objekt mosmarrëveshjeje, duke mos vlerësuar pasojat juridike të titujve të pronësisë së palëve, si dhe duke mos sqaruar ekzistencën ose jo të mbivendosjes së pronave dhe marrëdhënien juridike mbi sipërfaqen objekt gjykimi. Mosmarrëveshja ndërmjet palëve lidhet me përkatësinë e sipërfaqes së tokës, kufijtë e saj, ndërtimin e kryer nga i padituri P.N. dhe vlefshmërinë e akteve administrative të ndërtimit. Vendimi nr. 698/2008 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilin është pranuar pjesërisht padia e kërkuesit për ndryshimin e numrit kadastral në AMTP-në e tij nga 27/21 në 28/21, nuk ka përcaktuar kufijtë fizikë të pronës në terren, nuk ka miratuar skicë, nuk ka përcaktuar koordinata për vendndodhjen e saj dhe as nuk ka zgjidhur mosmarrëveshjen e pronësisë ndërmjet palëve, pra ai nuk ka prodhuar një përcaktim teknik përfundimtar të vendndodhjes së pronës në terren. Po kështu, me rrëzimin e padisë dhe të kundërpadisë në gjykimin e kundërshtuar, gjykatat nuk kanë përcaktuar as se kërkuesi ishte pronar, as se titulli i tij ishte absolutisht i pavlefshëm, as se të paditurit kishin një titull më të fortë, as se ku ndodheshin kufijtë realë ndërmjet pasurive, duke e lënë kështu të pazgjidhur konfliktin e pronësisë mes palëve. Gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e shkallës së parë me të njëjtin arsyetim, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, pa dalluar pretendimet që lidheshin me rivlerësimin e fakteve dhe të provave nga ato që kishin natyrë kushtetuese dhe procedurale.

23.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit,* pasi gjykatat nuk kanë arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme për vlerësimin e provave dhe të rrethanave vendimtare të çështjes, mbi të cilat kanë mbështetur rrëzimin e padisë së kërkuesit. Në këtë rast nuk mjaftonte shqyrtimi i veçuar i ekspertimit të administruar në gjykimin në shkallë

të parë, por duhej analizuar edhe raporti i tij me vendimet gjyqësore të formës së prerë nr. 698/2008 dhe nr. 1986/2008, me AMTP-në e kërkuesit, me pretendimin për mbivendosje dhe me aktet administrative të ndërtimit. Me vendimin nr. 698/2008 është pranuar se numri kadastral 27/21 nuk i përgjigjej vendndodhjes së tokës së përfituar nga kërkuesi dhe se pronës së tij i korrespondonte numri kadastral 28/21. Fakti që me këtë vendim është rrëzuar kërkimi për shoqërimin e AMTP-së me skicën përkatëse nuk e përjashtonte vlerën provuese të skicës së ekspertimit, për aq sa ajo kishte shërbyer si bazë teknike për identifikimin e parcelës 28/21. Megjithatë, gjykatat nuk kanë shpjeguar se përse ekspertimi i mëvonshëm mund të përdorej për të nxjerrë përfundime mbi vendndodhjen e pronës, për mbivendosjen dhe legjitimimin aktiv, pa u analizuar më parë raporti i tij me përmbajtjen detyruese të vendimit nr. 698/2008 dhe me efektet e vendimit nr. 1986/2008 për njohjen e pronësisë mbi ndërtimin dhe truallin funksional në vendin e quajtur "Bardhi". Për rrjedhojë, vendimmarrja e gjykatave mbetet e pamjaftueshme dhe kontradiktore në raport me provat dhe rrethanat vendimtare të çështjes. Po kështu, hetimi gjyqësor ka qenë i mangët, pasi vetë gjykata e shkallës së parë ka pranuar se, për shkak të mungesës së administrimit të plotë kadastral të zonës dhe të hartave që pasqyronin nënndarjet e parcelave, identifikimi i vendndodhjes së pasurive në terren ishte i vështirë, ndaj pasqyrimi i tyre sipas AMTP-ve duhej marrë me rezervë. Megjithatë, në vend që ky konstatim të çonte në sqarimin e raportit ndërmjet titujve, ekspertimeve dhe origjinës së pronësisë, ai u përdor si bazë për rrëzimin e kërkimeve të kërkuesit. Për rrjedhojë, vendimi nuk shpjegon mjaftueshëm bazën provuese dhe juridike të këtij përfundimi. Gjykata Administrative e Apelit në vijim nuk i korrigjoi të metat e arsyetimit, ndërsa Gjykata e Lartë u kufizua me mospranimin e rekursit, pa verifikuar nëse vendimi i gjykatës së apelit përmbushte detyrimin për arsyetim.

23.1.3. *Së drejtës për një mjet juridik efektiv* për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, pasi rekursi nuk ka shërbyer si mjet efektiv për shqyrtimin dhe korrigjimin e shkeljeve kushtetuese të pretenduara, për sa kohë Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, pa një vlerësim të pretendimeve të tij, edhe pse ajo kishte

detyrimin të verifikonte nëse gjykatat e faktit kishin dhënë një zgjidhje të arsyetuar mbi konfliktin juridik të pronësisë, nëse kishin respektuar autoritetin e gjësë së gjykuar të vendimeve nr. 698/2008 dhe nr. 1986/2008, si dhe nëse kërkuesi kishte marrë mbrojtje gjyqësore efektive për të drejtën pretenduar të pronësisë.

23.1.4. *Parimit të sigurisë juridike në drejtim të respektimit të autoritetit të gjësë së gjykuar,* pasi me vendimin nr. 698/2008 është pranuar se numri kadastral 27/21 nuk përputhej me tokën e përfituar nga kërkuesi, duke qenë se parcela përkatëse ndodhej në qendrën e banuar të fshatit Palasë, në zërin kadastral "pemëtore" dhe jo "ullishte", dhe se pronës së tij i korrespondonte numri kadastral 28/21. Këto konstatime, si pjesë e arsyetimit mbi të cilin ishte mbështetur korrigjimi i numrit kadastral, nuk mund të anashkaloheshin, por duhej të respektoheshin nga gjykatat në procesin e kundërshtuar, si pjesë e autoritetit të gjësë së gjykuar. Edhe pse në gjykimin e kundërshtuar gjykata e shkallës së parë ka njohur formalisht autoritetin e vendimit nr. 698/2008, ajo është mbështetur në një ekspertim të ri, që ka prodhuar një pozicionim të ndryshëm të pronës së kërkuesit nga ai i pasqyruar në planimetrinë e administruar në gjykimin e mëparshëm, për të arritur në përfundimin se nuk provohej mbivendosja me ndërtimin e P.N. dhe se kërkuesi nuk kishte legjitimim aktiv për kundërshtimin e lejeve të ndërtimit. Gjykatat u mbështetën në një ekspertim të mëvonshëm, që prodhonte përfundime të papajtueshme me konkluzionet e vendimit të formës së prerë nr. 698/2008, pa e ballafaquar me konstatimet e atij vendimi dhe me skicën planimetrike të aktit të ekspertimit që kishte shërbyer për dhënien e tij. Kjo mangësi nuk u korrigjua nga gjykata e apelit, ndërkohë që Gjykata e Lartë nuk ka shqyrtuar nëse gjykatat më të ulëta kishin respektuar kufijtë dhe pasojat juridike të vendimeve të formës së prerë.

23.2. *E drejta e pronës private dhe pritshmëritë e ligjshme,* pasi AMTP-ja e kërkuesit dhe vendimet e formës së prerë nr. 698/2008 e nr. 1986/2008 përbënin një bazë juridike të mjaftueshme për mbrojtjen e së drejtës së pronësisë, si dhe për pritshmëri të ligjshme të respektimit të efekteve të tyre. Megjithatë, gjykatat nuk i kanë dhënë

përgjigje të arsyetuar kërkimeve të tij, pasi, ndonëse titulli i tij i pronësisë nuk u shpall i pavlefshëm dhe kundërpadia u rrëzua, kërkimi për mbrojtjen e pronësisë u rrëzua pa u sqaruar në mënyrë të mjaftueshme vendndodhja e sipërfaqes së tokës objekt mosmarrëveshjeje dhe raporti ndërmjet titujve të pronësisë së palëve, vendimeve gjyqësore të mëparshme, ekspertimeve të administruara, mungesës së dokumentacionit kadastral hartografik, pretendimit për mbivendosje dhe lejeve të ndërtimit. Për pasojë, kërkuesi ka mbetur pa një vendimmarrje gjyqësore që të përcaktonte nëse sipërfaqja objekt mosmarrëveshjeje i përkiste atij, nëse e drejta e tij e pronësisë ishte cenuar dhe cilat pasoja juridike rridhnin nga aktet administrative të lejeve të ndërtimit.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

24. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

25. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të

plotësojë kriteret kumulative të parashikuara nga neni 71/a i Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

26. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, Kolegji mund të verifikojë një ose më shumë prej këtyre kritereve, pa qenë i detyruar të ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Mospërmbushja e njërit prej tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Mbi këtë bazë, Kolegji do të verifikojë plotësimin e kriterit *ratione materiae*.

27. Në drejtim të legjitimimit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e aksesit substancial në gjykatë, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, parimit të sigurisë juridike në drejtim të respektimit të autoritetit të gjësë së gjykuar dhe së drejtës për një mjet juridik efektiv, si dhe cenimin e së drejtës së pronës private dhe të pritshmërive të ligjshme. Këto pretendime, për nga natyra e të drejtave dhe standardeve të referuara, hyjnë në fushën e mbrojtjes kushtetuese. Megjithatë, Kolegji do të verifikojë nëse argumentet dhe rrethanat konkrete të parashtruara nga kërkuesi evidentojnë *prima facie* cenimin e këtyre të drejtave. Duke pasur parasysh lidhjen ndërmjet pretendimeve, të cilat mbështeten kryesisht në mënyrën e përcaktimit të vendndodhjes së pronës, interpretimin e vendimeve gjyqësore të mëparshme, vlerësimin e provave dhe mënyrën e shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, Kolegji çmon t'i shqyrtojë ato në mënyrë të lidhur, duke ruajtur veçoritë e secilit standard kushtetues.

28. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit në gjykatë, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin jo vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të marrë prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesi duhet të jetë substancial dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 73, datë 16.06.2026; nr. 22, datë 29.04.2021; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Gjykata ka theksuar gjithashtu se e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika

1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë, i qartë dhe jo kontradiktor në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre (*shih vendimet nr. 19, datë 10.04.2025; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, ky standard nuk kërkon që gjykata t'i japë përgjigje të hollësishme çdo argumenti të palëve, por që vendimi të përmbajë një përgjigje të mjaftueshme për pretendimet thelbësore dhe përcaktuese për zgjidhjen e çështjes (*shih vendimet nr. 69, datë 04.06.2026; nr. 35, datë 25.07.2011; nr. 23, datë 04.11.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se përcaktimi i fakteve dhe zbatimi i ligjit në çështjet konkrete janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 85, datë 23.12.2025; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik i bërë nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që e bën gjykimin të padrejtë *(shih vendimet nr. 11, datë 11.02.2026; nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 29, datë 01.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Në lidhje me parimin e sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar, Gjykata ka theksuar se autoriteti i gjësë së gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por edhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit, me kusht që të jenë kryer me qëllim dhënien e vendimit gjyqësor dhe t'u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj (*shih vendimet nr. 75, datë 28.10.2024; nr. 42, datë 27.12.2022; nr. 78, datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Duke iu kthyer rastit konkret, Kolegji vëren se mosmarrëveshjet ndërmjet palëve kanë qenë objekt i tre proceseve gjyqësore, në të cilat ka rezultuar se AMTP-të përkatëse nuk shoqëroheshin me skica ose harta që të mundësonin përcaktimin e vendndodhjes së pasurive në terren. Po kështu, nga ekspertimet e administruara në këto procese ka rezultuar se, ndonëse ekzistonte një hartë kadastrale që pasqyronte parcelën nr. 28, nuk ekzistonte dokumentacioni hartografik që të pasqyronte nënndarjet e saj sipas ligjit nr. 7501/1991, përfshirë ngastrat e përfituara nga palët ndërgjyqëse. Në këto kushte, ekspertët kanë evidentuar vështirësi për identifikimin dhe pozicionimin e pasurive në terren, për shkak të mungesës së administrimit të rregullt kadastral të zonës. Kolegji vëren se këto vështirësi lidhen me përcaktimin e vendndodhjes fizike të pasurive dhe nuk vënë në dyshim vlefshmërinë e titujve të pronësisë së palëve.

33. Kolegji konstaton se vështirësitë e mësipërme janë marrë në konsideratë nga gjykatat në dy proceset e mëparshme. Konkretisht, në gjykimin e përfunduar me vendimin nr. 698/2008, gjykata ka vendosur detyrimin e organit administrativ kompetent për të disponuar për ndryshimin e numrit kadastral të parcelës së kërkuesit nga 27/21 në 28/21, ndërsa ka rrëzuar kërkimin për shoqërimin e AMTP-së me skicë, për shkak të mungesës së dokumentacionit përkatës kadastral. Ndërkohë, në gjykimin e përfunduar me vendimin nr. 1986/2008, gjykata ka pranuar se, nga të dhënat e disponueshme, nuk mund të përcaktohej nëse ndërtimi i kërkuesit mbivendosej me pasuritë sipas AMTP-ve të palëve. Megjithatë, duke iu referuar edhe provave të tjera të administruara, përfshirë këqyrjen në vend dhe vendimin e Këshillit Popullor të fshatit Palasë, ajo ka njohur pronësinë e kërkuesit mbi ndërtesën dhe truallin funksional të saj, duke vlerësuar se kjo pasuri ndodhej jashtë sipërfaqes së tokës së dhënë në pronësi të Dh.N. Në këtë mënyrë, gjykatat kanë zgjidhur kërkimet konkrete të paraqitura përpara tyre, pa përcaktuar përfundimisht vendndodhjen dhe kufijtë fizikë të ngastrave të përfituara nga palët sipas ligjit nr. 7501/1991.

34. Për sa i përket procesit gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë ka administruar një akt ekspertimi topografik dhe shtesën e tij, nga të cilat kanë rezultuar vështirësi të ngjashme për përcaktimin e vendndodhjes së pasurive. Ekspertimi ka pasqyruar vendndodhjet e treguara nga palët sipas pretendimeve të tyre, si dhe ka evidentuar ndryshime ndërmjet pozicionimit të pronës së treguar në terren nga kërkuesi dhe atij të paraqitur në planimetrinë e administruar në gjykimin e përfunduar me vendimin nr. 698/2008. Në këtë kuadër, gjykata ka vlerësuar se, sipas titujve të pronësisë, pasuritë e kërkuesit dhe të Dh.N. identifikoheshin

me numrat kadastralë 28/21 dhe 28/29 dhe se ndërmjet tyre objektivisht nuk mund të kishte mbivendosje, për sa kohë u përkisnin ngastrave të ndryshme. Në mbështetje të këtij përfundimi, ajo i është referuar edhe vendimit nr. 1986/2008 dhe shtesës së aktit të ekspertimit, konkretisht skicës nr. 5. Nga ana tjetër, duke shqyrtuar pretendimet e palëve dhe rezultatet e ekspertimit, gjykata ka arritur në përfundimin se nuk ishte provuar që sipërfaqja e tokës, për të cilën kërkuesi kërkonte lirimin dhe dorëzimin, përfshihej në pronën e tij.

35. Në vlerësimin e Kolegjit, përfundimi i gjykatës së shkallës së parë për mungesën objektive të mbivendosjes ndërmjet pronave të palëve duhet kuptuar në raport me identifikimin e pasurive sipas titujve të pronësisë, që u referoheshin dy ngastrave me numra kadastralë dhe kufij të ndryshëm, brenda së njëjtës parcelë kadastrale. Megjithatë, identifikimi i dy pasurive juridikisht të dallueshme nuk nënkupton domosdoshmërisht përcaktimin e vendndodhjes dhe kufijve të tyre fizikë në terren, veçanërisht në kushtet e mungesës së dokumentacionit kadastral hartografik që pasqyronte nënndarjet e parcelës nr. 28. Në këtë kuptim, çështja e përkatësisë së sipërfaqes konkrete objekt gjykimi përbënte një aspekt të dallueshëm nga identifikimi i pasurive sipas titujve të pronësisë.

36. Kolegji vëren se, në procesin e kundërshtuar, kërkuesi ka kërkuar lirimin dhe dorëzimin e sipërfaqeve të tokës, duke pretenduar se ato përfshiheshin në pronësinë e tij sipas AMTP-së. Për pranimin e këtij kërkimi ka qenë e nevojshme që ai të provonte jo vetëm ekzistencën e titullit të pronësisë, por edhe përkatësinë e sipërfaqes konkrete objekt padie sipas atij titulli. Në këtë drejtim, gjykata e shkallës së parë ka marrë në shqyrtim pretendimet e palëve për vendndodhjen e pasurive, pozicionimin e pronës së kërkuesit sipas planimetrisë së administruar në gjykimin e përfunduar me vendimin nr. 698/2008, si dhe ndryshimet e konstatuara nga ekspertimi i mëvonshëm. Mbi bazën e vlerësimit të këtyre provave, ajo ka arritur në përfundimin se kërkuesi nuk kishte provuar që sipërfaqja e tokës, për të cilën kërkonte lirimin dhe dorëzimin, përfshihej në pronësinë e tij, ndaj e ka rrëzuar këtë kërkim si të pambështetur në ligj dhe në prova.

37. Në këto rrethana, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë nuk ka vënë në dyshim vlefshmërinë e titujve të pronësisë së palëve, por ka vlerësuar të paprovuar përkatësinë e sipërfaqes konkrete objekt padie në pronësinë e kërkuesit. Ky përfundim nuk është i barasvlershëm me përcaktimin se sipërfaqja e pretenduar i përkiste Dh.N., për sa kohë gjykata nuk ka bërë një përcaktim pozitiv të pronësisë së tij mbi këtë sipërfaqe. Në këtë kuptim, rrëzimi i padisë së

kërkuesit duhet dalluar si nga vlefshmëria e titullit të tij të pronësisë, ashtu edhe nga çështja e përcaktimit të vendndodhjes së saktë të pasurive të palëve në terren.

38. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *parimit të sigurisë juridike në drejtim të respektimit të autoritetit të gjësë së gjykuar,* Kolegji vëren se, sipas nenit 451/a të KPC-së, vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Po sipas këtij neni, vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për çka është vendosur midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak, ndërsa një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji parashikon ndryshe. Në këtë kuadër, për përcaktimin e shtrirjes së autoritetit të gjësë së gjykuar, rëndësi ka identiteti i palëve, i objektit dhe shkakut të padisë, si dhe konstatimet faktike dhe juridike që kanë qenë përcaktuese për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykimin e mëparshëm.

39. Në rastin konkret, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë ka marrë në konsideratë vendimet gjyqësore të mëparshme të formës së prerë, duke njohur efektet juridike të tyre. Kështu, ndonëse proceset gjyqësore kanë pasur lidhje me të njëjtët tituj pronësie dhe kanë përfshirë disa nga të njëjtat palë, ato kanë pasur objekte dhe kërkime të ndryshme. Konkretisht, gjykata e shkallës së parë, në procesin gjyqësor objekt të ankimit kushtetues individual, nuk ka vënë në diskutim konstatimet mbi të cilat ishte mbështetur vendimi nr. 698/2008 për korrigjimin e numrit kadastral të parcelës së kërkuesit, nga 27/21 në 28/21, dhe as njohjen e pronësisë së tij mbi ndërtesën dhe truallin funksional me vendimin nr. 1986/2008. Megjithatë, me vendimin nr. 698/2008, ndonëse është vendosur detyrimi i organit administrativ për të disponuar për korrigjimin e numrit kadastral, është rrëzuar kërkimi për shoqërimin e AMTP-së me skicë, ndërsa vendimi nr. 1986/2008 ka zgjidhur mosmarrëveshjen për ndërtesën dhe truallin funksional, pa përcaktuar kufijtë fizikë të ngastrave të palëve sipas AMTP-ve. Për rrjedhojë, këto vendime nuk kanë përcaktuar përfundimisht përkatësinë e sipërfaqes së tokës ullishte që është bërë objekt i gjykimit të mëvonshëm. Në këtë kuptim, nuk rezulton që gjykata e shkallës së parë të ketë arritur në përfundime të papajtueshme me konstatimet e vendimeve të mëparshme që kanë qenë përcaktuese për zgjidhjen e kërkimeve përkatëse. Po kështu, ekspertimet në procesin e kundërshtuar janë përdorur dhe vlerësuar për shqyrtimin e përkatësisë së sipërfaqes konkrete objekt padie, çështje

për të cilën nuk ishte vendosur përfundimisht në gjykimet e mëparshme. Për pasojë, argumentet e kërkuesit nuk evidentojnë *prima facie* cenim të autoritetit të gjësë së gjykuar.

40. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë ka marrë në shqyrtim dhe ka vlerësuar provat e administruara në raport me kërkimet e palëve, duke parashtruar arsyet për të cilat ka arritur në përfundimin se kërkuesi nuk ka provuar se sipërfaqja konkrete objekt padie përfshihej në pronësinë e tij. Në këtë drejtim, ndonëse gjykata ka konsideruar se ndërmjet pasurive të palëve objektivisht nuk mund të kishte mbivendosje, duke iu referuar identifikimit të tyre sipas titujve të pronësisë, ajo ka shqyrtuar edhe pretendimet për vendndodhjen e pasurive në terren dhe rezultatet e ekspertimit të administruar. Duke e vlerësuar arsyetimin e vendimit në tërësinë e tij, Kolegji çmon se gjykata ka parashtruar bazën faktike dhe juridike të përfundimit për rrëzimin e kërkimit të padisë për lirimin dhe dorëzimin e tokës, duke treguar në mënyrë të kuptueshme arsyet e vendimmarrjes së saj. Në këto rrethana, mospajtimi i kërkuesit me mënyrën e vlerësimit të provave dhe me përfundimin e arritur nga gjykata nuk përbën argument të mjaftueshëm për të evidentuar cenimin e standardit kushtetues të arsyetimit.

41. Po kështu, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar edhe kërkimin e padisë për pavlefshmërinë e lejeve të ndërtimit, duke vlerësuar se kërkuesit i mungonte legjitimimi aktiv për kundërshtimin e tyre, pasi, sipas shtesës së aktit të ekspertimit, referuar skicës nr. 6, nuk rezultonte që ndërtimi i P.N. të ndodhej në sipërfaqen e tokës në pronësi të kërkuesit. Nga ana tjetër, gjykata ka rrëzuar edhe kundërpadinë, duke mbajtur parasysh autoritetin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për titullin e pronësisë së kërkuesit dhe përfundimin se nuk rezultonte mbivendosje që të përligjte kundërshtimin e këtij titulli nga të paditurit/kundërpaditës. Në këtë mënyrë, gjykata ka parashtruar arsyet për rrëzimin e këtyre kërkimeve, në raport me provat e administruara dhe kushtet ligjore për pranimin e tyre.

42. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës së aksesit substancial në gjykatë,* Kolegji vlerëson se ai duhet të shqyrtohet në raport me objektin e mosmarrëveshjes dhe kërkimet konkrete të paraqitura përpara gjykatave. Në rastin konkret, kërkimi për lirimin dhe dorëzimin e sipërfaqes së tokës është marrë në shqyrtim dhe është rrëzuar për shkak se kërkuesi nuk ka provuar që kjo sipërfaqe përfshihej në pronësinë e tij. Po kështu, gjykata ka shqyrtuar dhe ka vendosur edhe për kërkimet e tjera të padisë dhe kundërpadisë. Ndërkohë, hartimi dhe pasqyrimi në

dokumentacionin zyrtar kadastral i nënndarjeve të tokës së përfituar sipas ligjit nr. 7501/1991 përbën një proces me natyrë dhe objekt tjetër nga gjykimi i padisë së rivendikimit. Në këto rrethana, mungesa e përcaktimit përfundimtar të vendndodhjes së pasurive në terren nuk mund të barazohet me mungesën e një zgjidhjeje gjyqësore për kërkimet konkrete të shqyrtuara nga gjykatat. Për rrjedhojë, duke mbajtur parasysh edhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore, Kolegji çmon se argumentet e kërkuesit nuk evidentojnë *prima facie* cenimin e së drejtës së aksesit substancial në gjykatë.

43. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për një mjet juridik efektiv, Kolegji vëren se, nisur nga argumentet e parashtruara në mbështetje të tij, ky pretendim lidhet, në thelb, me të drejtën e aksesit në gjykatë, në aspektin e ankimit efektiv, dhe me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Konkretisht, kërkuesi ka kundërshtuar mospranimin e rekursit nga Gjykata e Lartë, duke pretenduar se kjo e fundit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij me natyrë kushtetuese. Në këtë drejtim, Gjykata ka pohuar se vendimet e mospranimit të rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, në përputhje me natyrën e shqyrtimit në dhomën e këshillimit. Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime me natyrë kushtetuese, Gjykata e Lartë, në respektim të parimit të subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në shqyrtimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur për to në raport me përfundimin e arritur për mospranimin e rekursit (*shih vendimet nr. 12, datë 15.03.2023; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 11, datë 16.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka pasqyruar në vendimin e tij shkaqet e rekursit, përfshirë kundërshtimet lidhur me zbatimin e parimit të gjësë së gjykuar, interpretimin e vendimeve gjyqësore të mëparshme, mënyrën e vlerësimit të ekspertimeve dhe mangësitë e pretenduara të hetimit gjyqësor. Në vijim, pasi ka analizuar juridiksionin e tij rishikues dhe kushtet ligjore për pranimin e rekursit, ai ka arritur në përfundimin se argumentet e parashtruara nuk përmbushnin shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, sipas përmbajtjes së tij në kohën e paraqitjes së rekursit.

44. Në vlerësimin e Kolegjit, fakti që Gjykata e Lartë nuk ka dhënë përgjigje të veçantë për secilin argument të rekursit duhet shqyrtuar në raport me përmbajtjen e këtyre argumenteve dhe arsyetimin e vendimeve të gjykatave të faktit. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se kërkuesi ka kundërshtuar veçanërisht mënyrën e zbatimit të parimit të gjësë së gjykuar dhe përdorimin e

planimetrisë së administruar në gjykimin e përfunduar me vendimin nr. 698/2008 për përcaktimin e vendndodhjes së pronës së tij. Megjithatë, siç është analizuar më sipër, gjykatat e faktit nuk kanë ndryshuar përcaktimet detyruese të vendimeve të mëparshme dhe as kanë vënë në dyshim titullin e pronësisë së kërkuesit, por kanë shqyrtuar nëse ai ka provuar që sipërfaqja konkrete për të cilën kërkonte lirimin dhe dorëzimin përfshihej në pronën e tij. Po kështu, ato kanë parashtruar arsyet mbi të cilat kanë mbështetur përfundimin për rrëzimin e kërkimeve të padisë dhe të kundërpadisë. Në këto rrethana, Kolegji çmon se argumentet e rekursit, edhe për sa i përket respektimit të autoritetit të gjësë së gjykuar dhe standardit të arsyetimit, nuk evidentonin ndonjë mangësi kushtetuese të vendimmarrjes së gjykatave të faktit që të kërkonte një përgjigje të posaçme nga Gjykata e Lartë. Për rrjedhojë, duke mbajtur parasysh edhe natyrën e juridiksionit të saj rishikues, arsyetimi i kufizuar i vendimit të mospranimit të rekursit nuk evidenton, në rastin konkret, cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, në aspektin e ankimit efektiv, ose të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

45. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës së pronës private dhe të pritshmërive të ligjshme,* Kolegji vëren se gjykatat nuk kanë mohuar vlefshmërinë e titullit të pronësisë së kërkuesit. Përkundrazi, ato kanë marrë në konsideratë AMTP-në e tij dhe vendimet gjyqësore të mëparshme të formës së prerë, duke njohur efektet juridike të tyre. Në këtë kuptim, titulli i pronësisë së kërkuesit dhe të drejtat e njohura me vendimet gjyqësore të mëparshme nuk janë vënë në diskutim nga vendimmarrja e kundërshtuar. Ndërkohë, rrëzimi i kërkimit për lirimin dhe dorëzimin e sipërfaqes së tokës është mbështetur në përfundimin se kërkuesi nuk ka provuar që sipërfaqja konkrete objekt mosmarrëveshjeje përfshihej në pronën e njohur me titullin e tij. Për rrjedhojë, ekzistenca e këtij titulli dhe e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nuk mjafton për të provuar përkatësinë e sipërfaqja konkrete objekt gjykimi, pa u provuar lidhja e saj me titullin përkatës. Në këto rrethana, Kolegji vlerëson se argumentet e kërkuesit nuk evidentojnë *prima facie* cenimin e së drejtës së pronës private ose të pritshmërive të tij të ligjshme.

46. Për sa më sipër, Kolegji çmon se argumentet e parashtruara nga kërkuesi nuk evidentojnë *prima facie* cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e pretenduara, si dhe të së drejtës së pronës private dhe të pritshmërive të ligjshme. Për rrjedhojë, pretendimet e tij janë haptazi të pabazuara.

47. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "e", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.